



MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tirane

Nr. Prot

Tiranë, më ____/____/2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: Blerje Gazra të ndryshme mjeksore për "Riprodhimin e Asistuar" në S.U.O.GJ "Koço Gliozheni"

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Gazra Mjeksor

VLERA E FONDIT LIMIT: Vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen gjatë Marrëveshjes Kuadër me afat 12 muaj: 8,231,000(*tetë milion e dyqind e tridhjetë e një mijë*) leke pa TVSH..

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", autoriteti/enti kontraktor **Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tirane**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

2.1.1 Sipas kriterëve të përgjithshme të kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Kriteri 2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare (2020,2021,2022) , ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës fondit limit/vlera e pritshme të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë 3 viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, vlera mesatare do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar sipas sasive të pritshme të lotit/lotëve për të cilën ofertohej.

Nëse operatorët ekonomikë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DST, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi:Ky kriter është vendosur në përputhje me pikën 3 të nenit 77 të Ligjit nr 162/2020,“Per Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në pikën 1 dhe pikën 2/c të nenit 43 të VKM nr. 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: Pika 1.Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika 2/c: c) 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedrat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nepermjet dokumenteve të kërkuara se zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: *Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 29, të Ligjit Nr. 8438, dt. 28.12.1998 "Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, ku përcaktohet: *Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë të Financave në zbatim të këtij ligji.*

*Tatimpaguesit paraqesin deklaraten vjetore ne organet **tatimore** brenda dates 31 mars te vitit pasardhes.*

2.3 Kapaciteti teknik:

Kriteri 2.3.1 *Deshmi nga operatori ekonomik per furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë sa 20% e vleres së fondit limit dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik per permbushjen me sukses të kontratës, ku e shënohet vlera, afati i përfundimit te kontrates ose/dhe fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave te legjislacionit ne fuqi, dhe te deklaruar ne organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi:*Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162/2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 55 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: [...]4. (b)Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.*

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Kriteri 2.3.2 *Auto-deklarate për origjinën e mallit, ku te përcaktohet vendi i prodhimit dhe kompania prodhuese.*

Argumentimi: Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese/mbajtesin e autorizimit për tregtim për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimit të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacione ne përputhje me nenin 40, pika 6 dhe 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Kriteri 2.3.3 Ofertuesi duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi i mallrave (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) për lejimin e tregtimit të mallrave të kërkuara në specifikimet teknike, të përkthyer dhe noterizuar. Në rast se OE është vet prodhues, duhet të paraqesë vetedeklarim me shkrim.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021.

Kriteri 2.3.4 - Operatori duhet të paraqesë vërtetimin e leshuar nga I.SH.T.I që disponon të paktën 500 bomblla të regjistruara pranë këtij institucioni.

Argumentim: Ky kriter vendoset në përputhje me nenin 77, pika 1/c të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik”, me qëllim garantimin e furnizimit me këtë mall për shkak të vetë specifikave të tij dhe rëndësisë që ka për funksionimin normal të institucioneve spitalore si dhe për të provuar kapacitetin teknik të OE me qëllim përmbushjen e kontratës. Bazuar në ligjin Nr.32/16 ,datë 24.03.2016 ,”Garantimin e sigurisë së punës të paisjeve dhe enëve nën presion “.

Kriteri 2.3.5 Vërtetim për regjistrim dhe kontroll nga inspektoriati i pajisjeve nën presion, për plotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë konform legjislacionit në fuqi që vepron në RSH.

Argumentim: Ky kriter vihet në përputhje me nenin 40 pika 6/c të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit mund të kërkohen dëshmi për realizimin e testeve zyrtare të lëshuara nga institucione të autorizuar që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike dhe është në përputhje me objektin e kontratës. Është patur parasysh se protoksid azoti , mund të tregtohet i ambalazhuar me bombolla, të cilat duhet të plotësojnë kushtet e sigurisë konform legjislacionit për enët nën presion.

Kriteri 2.3.6 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë dhe/ose skedë teknike për mallrat e ofruara. Në katalogë/skede teknike, specifikimet teknike të mallit duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas specifikimeve teknike të kërkuara. (Katalogët duhet të ngarkohen në www.app.gov.al së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DST (Dokumentat duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuar si dhe plotëson kërkesat e AK .

Kriteri 2.3.7 Operatori ekonomik duhet të jetë I regjistruar në regjistrin tregtar ,të ketë në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit dhe të ketë statusin aktiv

Kriteri 2.3.8 Operatori ekonomik duhet të garantojë transportin e gazrave me makinat e veta ,ose të marra me qera ,të cilat duhet të jenë të pajisura me dokumentacionin që vërteton lejimin e transportit të bombulave me gazet mjeksore të kërkuar.

Kriteri 2.3.9 Operatori ekonomik duhet të ketë fatura tatimore të mëpareshme që vërtetojnë prokurimin e këtyre gazeve.

Specifikime teknike

Nr.	Emertimi	Specifika	Njesia	Per 100 paciente IUI ,100 IVF,100 Embriotrasferta
1	Bombel gaz CO2 mjeksor	1 Bombul =40kg<>CO2	kg (1bombul =40kg/ ><CO2)	1,200
2	Bombel gaz N2 mjeksor	1 Bombul =10 m3 ><N2 mjeksor	m3 (1 bombul=10 m3>< N2 mjeksor)	100
3	Bombel gaz miks dhe 6%CO2,5%O2 dhe 89%N2	1 Bombul =10 m3><gazi miks 6%CO2,5%O2 dhe 89%N2	m3 (1 bombul= 10 m3 ><gazi miks 6%CO2,5%O2 dhe 89%N2)	240
4	Azot I lenget	Liter	Liter	1,800

Afati i skandencës do të jetë : Data e skandencës në ditën e lëvrimit të mallit duhet të jetë jo më pak se ½ e kohës ndërmjet datës së prodhimit dhe asaj të skandencës.

Kontraktuesi ka për detyrë të mirëmbaje, kolaudojë dhe të riparojë bombolat me shpenzimet e veta në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik Industrial (ISHTI).

- Çdo furnizim të shoqërohet me flete analize

- Transportimi dhe shkarkimi i bombulave të kryhet nga kontraktuesi deri brenda në magazinën e Spitali Universitar Obstetrik-Gjinekologjik "Koço Gliozheni" Tiranë

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, "b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrimi i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzimi i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë" si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", "për mallrat që do të prokurohen, autoriteti/enti kontraktor parashikojnë specifikimet teknike, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementëve më të rëndësishëm përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara."

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj"**.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

Specifikimet sipas DST-se.

Argumentimi: Specifikimet teknike të mësipërme plotësojnë kushtin për materiale cilësore dhe janë përcaktuar në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, pika 3/b të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

NJËSIA E PROKURIMIT: